

Ky raport përmban të dhëna të grumbulluara në periudhën tetor 2018 – shkurt 2019 nga monitorimi i proceseve disiplinore dhe atyre të ankesave brenda ATK-së.

Raporti, gjithashtu përmban të dhëna nga analizimi i vendimeve disiplinore, ankesave dhe vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të cilat janë nxjerrë gjatë vitit 2018.

Hulumtimi ka për qëllim të monitorojë edhe procedurat e deklaramit të konfliktit të interesit dhe deklaramit të pasurisë brenda ATK-së duke sjellë një analizë për gjendjen aktuale dhe të ofrojë rekomandime konkrete për ndryshime të mundshme.

Duke kryer monitorime direkte, duke testuar procedurat e reagimit dhe analizuar statistikën e nxjerra, raporti ka matur edhe procedurat e raportimit të rasteve në linjat e raportimit të ATK-së, të cilat janë ta hapura për raportimin e korrupsionit dhe keqpërdorimeve brenda ATK-së.

Për këtë qëllim, BIRN dhe D+ kanë analizuar po ashtu 17 vendime disiplinore të nxjerra nga komisionet brenda ATK, si dhe ka analizuar 9 vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës. Po ashtu, BIRN dhe D+ kanë monitoruar edhe 3 raste direkte që janë trajtuar nga organet disiplinore të ATK-së gjatë periudhës direkte të monitorimit.